

---

**Njoftim për shtyp  
(datë 30 Shtator 2014)**

**Mbi takimin mes Komisionit të Konkurrencës dhe Bordit Drejtues të ERE-s mbi  
çështje të liberalizimit dhe konkurrencës në sektorin e energjisë elektrike dhe  
gazit**

Sot paradite në ambjentet e Autoritetit të Konkurrencës u zhvillua një takim mes dy organeve vendimmarëse të Autoritetit të Konkurrencës dhe Entit Rregullator të Energjisë, lidhur me disa çështje të liberalizimit të tregut dhe konkurrencës në sektorin e energjisë elektrike dhe sektorin e gazit natyror.

Gjatë diskutimeve u ritheksua domosdoshmëria e bashkëpunimit midis dy rregullatoreve për mirefunksionimin dhe rritjen e efikasitetit në tregun e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, si në aspektin monitorues, ashtu edhe në aspektin ligjor. Nga ana e përfaqësuesve të ERE-s u shprehë gadishmëria për ta thelluar bashkëpunimin në drejtim të diskutimit të problematikave që mund të paraqesin aktet ligjore dhe nënligjore në fushën e energjisë elektrike dhe të gazit natyror në fazën e ndryshme të zhvillimit të tregut.

Të dy institucionet do të bashkëpunojnë ngushtësisht gjatë procesit të hartimit dhe përmirësimit të dokumentave strategjikë për zhvillimin e tregut si Modeli i Tregut të Energjisë Elektrike, Tregut të Gazit, p-ligji “Për energjinë elektrike”, p-ligji “Për gazin natyror”, draft-rregulloret për blerjen e energjisë elektrike dhe procesit të diskutimit të tarifave të energjisë për operatorët e prodhimit, sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike.